REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË - MINISTAR SPORTA I OMLADINE - MINISTER OF SPORTS AND YOUTH
Nr. prot. 06 Shenja klas. 66
Nr.Pro/Viti 313/2026
Data 14.05.2026
Nënshkrimi
Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Sportit dhe Rinisë – Ministarstvo Sporta i Omladine – Ministry of Sport and Youth

Prishtinë, Maj 2026

FONDI PËR SHËRIMIN E LËNDIMEVE TË PROFESIONISTËVE NË FUSHËN E SPORTIT PËR VITIN 2026

QËLLIMI I THIRRJES

Bazuar në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndër prioritetet e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë për vitin 2026 është mbështetja e individëve të cilët e zhvillojnë veprimtarinë e tyre profesionale në fushën e sportit për tejkalimin e sfidave potenciale që mund të kenë gjatë karrierës së tyre aktive përmes Fondit për Shërimin e Lëndimeve.

Fondi për Shërimin e Lëndimeve synon mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të shërbimeve mjekësore për shërim *në rast të lëndimeve fizike që ndodhin gjatë aktivitetit sportiv stërvitor apo garues*. Profesionistët në fushën e sportit mund të aplikojnë në formatin e mbështetjes së mëposhtme:

1. **Mbështetja financiare për shërimin e lëndimeve**

Në kuadër të **"Mbështetjes financiare për shërimin e lëndimeve"** parashihet mbështetja e plotë ose/apo e pjesëshme e kostos financiare për intervenimet operative të përgjithshme apo specifike në rast të lëndimeve fizike të sportistëve, trajnerëve, referëve/gjyqtarëve gjatë aktivitetit të tyre sportiv profesional.

Vlerësimi i aplikimeve kalon në dy faza:

1. ***Vlerësimi administrativ*:**

   Identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike.

2. **Vlerësimi përmbajtësor që identifikon:**
   - Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e sportit;
   - Nëse kostot e kërkesës janë reale karshi çmimeve të tregut të shërbimeve shëndetësore;
   - Nëse aplikuesi ka përfunduar të gjitha obligimet paraprake ndaj MSR-së (nëse është përfitues i thirrjeve paraprake).

Në rast të dështimit për të përmbushur kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Specifikacionet e thirrjes janë të elaboruara më poshtë, duke zbërthyer kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, afatet kohore, procesin e aplikimit, si dhe shkallën maksimale të mbështetjes.

Kush mund të aplikojë:

Aplikimi për mbështetje financiare në kuadër të **"Fondit për shërimin e lëndimeve të profesionistëve në fushën e sportit"** bëhet vetëm nga individët e profilizuar në fushën e sportit.

Individët me shtetësi të Republikës së Kosovës, të cilët ushtrojnë veprimtaritë përkatëse profesionale në fushën e sporti (sportistët, trajnerët, referët) në Kosovë dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kjo thirrje publike nuk parasheh mbështetjen financiare për sportistët të cilët janë njëkohësisht anëtarë/ punëtorë të institucioneve publike të Republikës së Kosovës.

Kriteret e përgjithshme minimale për profesionistët e fushës së sportit janë:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Për sportistët nën moshën 18 vjeçare, certifikata e lindjes dhe/ose pasaporta e fëmijës dhe letërnjoftimi i prindit/kujdestarit;
- Për aplikuesit nën moshën 18 vjeçare, dokumentacionet e kërkuara dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për të cilat të miturit nuk mund të japin përgjegjësi, duhet të plotësohen në emër të prindit/ kujdestarit;
- Të dëshmojë arritjet profesionale në sportin përkatës e cila duhet të vërtetohet nga klubi/federata përkatëse;
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesit/udhëheqësit të aplikuesit dhe Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Aplikuesi në "Fondin për shërimin e lëndimeve të profesionistëve në fushën e sportit" nuk lejohet të jetë i punësuar në MSR ose në institucione vartëse të saj.

Kriteret e veçanta për profesionistët e fushës së sportit janë:

- Sportistët dhe trajnerët duhet të jenë anëtarë të klubeve sportive të licencuara pranë MSR-së të cilat janë anëtare të federatave përkatëse sportive në Republikën e Kosovës po ashtu të licencuara pranë MSR-së, ndërsa referët/gjyqtarët duhet të jenë zyrtarë të federatës përkatëse të licencuara pranë MSR-së;
- Mbështetja financiare mund të kërkohet vetëm për lëndimet të cilat kanë ndodhur gjatë aktivitetit stërvitor apo garues të sportistit, referit/gjyqtarit ose trajnerit *(në këtë pikë përjashtohen lëndimet të cilat nuk janë të lidhura me aktivitetin sportiv)*;
- Intervenimi operativ për të cilin kërkohet mbështetja financiare mund të kryhet në institucionet

shëndetësore publike apo private të licencuara në Republikën e Kosovës apo në institucionet shëndetësore publike dhe private jashtë vendit *(aplikuesi mund të përkrahet për intervenim të lëndimeve specifike jashtë vendit vetëm atëherë kur dëshmohet se shërbimi specifik për të cilin ka nevojë nuk ofrohet në institucionet shëndetësore vendore, qoftë publike apo private);*

- Mbështetja financiare mund të kërkohet edhe për trajtimin e lëndimeve që kanë ndodhur para hapjes së thirrjes për shërimin e lëndimeve të sportistëve *(në këtë pikë përfshihen lëndimet të cilat kanë ndodhur nga periudha janar 2025, deri në periudhën e mbylljes së kësaj thirrjeje);*
- Intervenimi operativ për të cilin kërkohet mbështetja financiare duhet të jetë me Raport të mjekut nga institucionet publike apo private, vendore ose ndërkombëtare shëndetësore;
- Shuma e kërkesës për financim duhet të jetë në përputhshmëri me *faturën / pro-faturën* e institucionit ku do të kryhet shërbimi shëndetësor *(aplikuesi duhet të dëshmojë çmimin e tregut për shërbim duke sjellur faturë /pro-faturën nga institucioni shëndetësor);*
- Në rastet kur individi aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërimin e lëndimeve të cilat janë realizuar para hapjes së thirrjes, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin e pranuar nga institucionet shëndetësore *(përmes raportit të mjekut, faturës së rregullt dhe transaksionit bankar - për pagesa mbi 300.00 EUR)*;
- Në rastet kur aplikuesi aplikon për mbulim të shpenzimeve për shërbime mjekësore të cilat do t'i realizojë pas aplikimit për mbështetje financiare, aplikuesi duhet të dëshmojë shërbimin që do të pranojë përmes: **raportit të mjekut,** dhe **faturës / pro-faturës së lëshuar nga institucioni shëndetësor ku do të realizojë intervenimin).**

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 5,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për profesionistët e fushës së sportit

Aplikimi i individëve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në vijim:

1. Formularin e aplikimit (të plotësuar dhe nënshkruar);
2. Formularin e propozim buxhetit (të plotësuar dhe nënshkruar);
3. Formularin e deklaratës mbi financimin e dyfishtë (të plotësuar dhe nënshkruar);
4. Kopje e letërnjoftimit ose pasaportës *(për ata nën moshën 18 vjeç, certifikata e lindjes së fëmijës dhe kopja e letërnjoftimit/ pasaportës së prindit/ kujdestarit);*
5. Për aplikuesit nën moshën 18 vjeçare të cilët përfaqësohen nga kujdestari, akt dëshmi për kujdestari;
6. Vërtetimi nga klubi /ose federata sportive përkatëse e licencuar në MSR për anëtarësi në klubin përkatës *(vetëm për sportistët apo trajnerët);*
7. Vërtetimin nga federata sportive përkatëse e licencuar në MSR për anëtarësi në federatën përkatëse *(për referët/gjyqtarët);*
8. Raporti i Mjekut që përfshinë diagnozën dhe trajtimin, me vulë dhe nënshkrim të mjekut nga Institucioni Shëndetësor në vend apo jashtë vendit;

9. Për mbështetjen e intervenimeve jashtë vendit: raporti mjekësor i kolegjiumit të mjekëve për trajtim jashtë vendit;
10. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat do të realizohen pas aplikimit në thirrjen e Fondit për shërimin dhe rikuperimin e lëndimeve duhet të ofrohet pro-faturë e institucionit shëndetësor vendor ku do të kryhet intervenimi apo seancat e rikuperimit *(pro-fatura e vulosur e institucionit shëndetësor t'i bashkëngjitet Formularit për propozim të buxhetit);*
11. Në raste kur aplikohet për mbështetjen financiare të intervenimeve të cilat janë realizuar para aplikimit në thirrjen e Fondit për Shërimin e Lëndimeve Sportive:
    11.1. Fatura e rregullt e institucionit shëndetësor ku është realizuar intervenimi;
    11.2. Dëshmi mbi transaksionin bankar për të gjitha faturat në vlerë mbi 300.00 EUR.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Individët duhet të aplikojnë në Fondin për Shërimin e Lëndimeve të Profesionistëve në Fushën e Sportit vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në ueb-faqen e MKRS-së: www.mkrs-ks.org

Aplikimi duhet të dorëzohet në formë fizike me zarf të mbyllur, mbi të shënohet emri i thirrjes publike, si dhe emri dhe mbiemri i aplikuesit. Dokumentacioni dorëzohet në zyrën nr. 22 (zyra e arkivës) të Ministrisë së Sportit dhe Rinisë.

Më shumë informacione rreth thirrje publikes:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike **"Fondi për Shërimin e Lëndimeve të Profesionistëve në Fushën e Sportit 2026"** mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e- mail në adresën adelina.dreshaj@rks-gov.net, jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm aplikimet që janë dërguar/pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është deri me datën: **11.06.2026.**